

**VENDIM**  
**Nr.34, datë 8.10.2010**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                   |                                |   |   |
|-------------------|--------------------------------|---|---|
| Vladimir Kristo   | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |   |   |
| Petrit Plloçi     | anëtar i                       | “ | “ |
| Vitore Tusha      | anëtare e                      | “ | “ |
| Sokol Sadushi     | anëtar i                       | “ | “ |
| Sokol Berberi     | anëtar i                       | “ | “ |
| Admir Thanza      | anëtar i                       | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj    | anëtare e                      | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | anëtar i                       | “ | “ |

me sekretare Blerina Çinari, në datë 21.9.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: Lutfi Domi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.156, datë 3.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i vendimit nr.65, datë 12.2.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, i vendimit nr.293, datë 11.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i vendimit nr.197, datë 3.6.2005 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe i vendimit nr.310, datë 14.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE**

**VËREN:**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.310, datë 14.5.2004, ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të “shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, duke e dënuar atë me 7 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.197, datë 3.6.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.293, datë 11.5.2005, vendosi “lënien në fuqi të vendimit nr.197, datë 3.6.2005 të Gjykatës së Apelit Durrës përse i përket deklarimit fajtor, cilësimit ligjor të veprës e masës së dënimit për të gjykuarin Dritan Domi (bashkautor me kërkuesin). Prishjen e vendimit të mësipërm për të gjykuarin Lutfi Domi (kërkuesin) e dërgimin e akteve për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Durrës me një tjetër trup gjykues.”

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.65, datë 12.2.2007, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për të pandehurin Lutfi Domi sa i takon deklarimit fajtor, kualifikimit të veprës penale në ngarkim të tij dhe ndryshimin vetëm për masën e dënimit.”

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.156, datë 3.4.2009, ka vendosur:

“Mospranimin e rekursit të paraqitur si nga prokurori ashtu edhe nga kërkuesi”.

Kërkuesi, më datë 9.5.2008, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese për këto arsye:

a) Kërkuesit i është cenuar e drejta e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme për shkak se në të njëjtin proces gjyqësor, në shkallë të ndryshme, kanë marrë pjesë 2 gjyqtarë të njëjtë. Kështu, në procesin për caktimin e masës së sigurimit për kërkuesin, gjyqtarja Majlinda Andrea ka vendosur masën e sigurimit të arrestit me burg. Po kjo gjyqtare ka qenë në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuesit që ka vendosur mospranimin e tij. Gjithashtu, gjyqtari Besnik Imeraj ka qenë anëtar i trupit gjykues për shqyrtimin e apelit ndaj vendimit të sigurimit të provës së dëshmitares. Po ky gjyqtar ka marrë pjesë në shqyrtimin e rekursit të kërkuesit që ka vendosur mospranimin e tij.

b) Kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes, pasi në seancën për sigurimin e provës kërkuesit i është caktuar avokat kryesisht, megjithëse ai nuk ishte shprehur se kërkonte avokat.

c) Mbrojtja e kërkuesit nuk ka qenë efektive, pasi të dy të pandehurit janë mbrojtur nga i njëjti avokat gjatë seancës për sigurimin e provës.

Në datë 21.7.2010, kërkuesi paraqiti një kërkesë tjetër para kësaj Gjykate, me anë të së cilës kërkoi heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile (KPC), neni 299/b, i cili parashikon se “gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë”.

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC-së.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenin 299 të KPC-së, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj